



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE
DEPARTAMENTI I PRODHIM MENAXHIMIT**

Sheshi “Nënë Tereza” Nr. 4 Tiranë, Shqipëri

www.fim.edu.al

Tel/fax: +355 4 2223707

Tiranë, më 6.11.2017

Njoftim për hapjen e kursit të formimit të vazhduar “Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve”

Në përputhje me ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Nr. 80, datë 22. 07. 2015, si dhe si dhe miratimin e ndryshimeve nga ana e Senatit akademik të UPT, pranë Departamentit të Prodhim Menaxhimit në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, propozojmë hapjen e programit të trajnimit për **“Vlerësues i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve”**.

Propozojmë që kursi të fillojë në datë **1 Dhjetor 2017** dhe do të shërbejë për trajnimin e të gjithë personave që duan të konkurrojnë për të fituar një çertifikatë (liçensë) për ushtrimin e aktivitetit të **“Vlerësuesit të linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve”** në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 712, datë 12.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e liçensimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme”.

Aplikimet për ndjekjen e këtij programi të bëhen pranë:

Sekretarisë të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike nga data 7 Nëntor 2017 – 30 Nëntor 2017, çdo ditë pune nga ora 10:00 – 16:00.

Koordinator i miratuar i këtij kursi është **Dr. Ilo BODI**.

Dokumentat që duhen paraqitur janë:

- 1) Formular aplikimi (modeli bashkangjitur);
- 2) Dokument identifikimi (fotokopje të kartës së identitetit ose pashaportës);
- 3) Fotokopje të diplomës universitare të noterizuar + Listë notash;
- 4) Çertifikata të ndryshme që zotëron kandidati
- 5) Mandati i pagesës së tarifës 1600 lekë për rregjistrim.

Ju lutem bëni njoftimet përkatëse për të interesuarit.

**Përgjegjësi i Departamentit
Dr. Ilo BODI**